VENDIM
Nr. 410, datë 11.7.2007

PËR TRANSFERIMIN E PAKETËS SË AKSIONEVE TË AMC SHA, QË KA MBETUR PAS TRANSFERIMIT TË PAKETËS TEK INVESTITORËT STRATEGJIKË, TEK ISH-PRONARËT E TRUALLIT DHE TE PUNONJËSIT E KËSAJ SHOQËRIE

(Ndryshuar me VKM nr. 505, datë 1.5.2008)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 9 të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998 "Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë" dhe të neneve 2, 3, pika 3, e 6, të ligjit nr.8515, datë 21.7.1999 "Për privatizimin e shoqërisë anonime "Albanian Mobile Communications" (AMC)", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Paketa e aksioneve të AMC sh.a., që ka mbetur pas transferimit të paketës tek investitorët strategjikë, tek ish-pronarët e truallit dhe të punonjësit e kësaj shoqërie të transferohet, nëpërmjet ankandit, me asistencën e shoqërisë konsulente ndërkombëtare.

2. *Shpenzimet për realizimin e procedurave të përzgjedhjes së konsulentit për shërbimet e tij, si dhe shpenzimet e tjera, të nevojshme për transferimin e paketës, të përballohen nga të ardhurat e realizuara nga shitja e paketës së aksioneve shtetërore, të mbetura në shoqërinë anonime AMC.*

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha